



Menaxhimi i Projekteve

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Java VII

Menaxhimi i Projekteve

Përmbajtja

Menaxhimi i Projekteve;

|

- ▶ **Menaxhimi i Rrezikut të Projektit**
- ▶ Identifikimi dhe vlerësimi i riskut,
- ▶ Analizat kualitative dhe kuantitative të Rrezikut.
- ▶ Strategjia e minimizimit të riskut.
- ▶ Menaxhimi i riskut të projektit – një metodë e integruar



Menaxhimi i Projekteve;

Menaxhimi i Rrezikut të Projektit, procesi dhe metodat.

Identifikimi dhe vlerësimi i riskut,

Analizat kualitative dhe kuantitative të Rrezikut.

Strategjia e minimizimit të riskut, planifikimi i përgjigjes ndaj rrezikut.

Monitorimi dhe kontrolli i Rrezikut

Menaxhimi i riskut të projektit – një metodë e integruar

Rreziqet e projektit

Projektet operojnë në mjedis të përbërë nga pasiguri. Ka pasiguri në lidhje me:

- ▶ financimin e projektit,
- ▶ disponibilitetin e burimeve të nevojshme,
- ▶ problemet e mundëshme teknike,
- ▶ e shumë të tjera.

Këto pasiguri formojnë bazat për riskun e projektit dhe për nevojën e angazhimit në menaxhimin e riskut.



Menaxhimi i Riskut

Menaxhimi i riskut përcaktohet si arti dhe shkenca e identifikimit, analizës dhe reagimit ndaj faktorëve të riskut gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit dhe në interesin e objektivave të tij.

- ▶ Risku i projektimit mund të përcaktohet thjesht si një ngjarje e mundëshme që mund të ndikojë negativisht gjatë gjithë jetës së projektit. Wideman e përcakton riskun e projektit: **një vlerësim i probabilitetit të humbjes nga një mori e madhe situatash të padëshiruara.**



Menaxhimi i Riskut

Një risk ose ngjarje ka një shkak dhe në qoftë se kjo ndodhë atëherë ka një pasojnë.

Kjo do ndikojë ne koston e projektit, në afatin e tij apo edhe ne cilësinë e projektit.

Përpjekjet e menaxhmentit të riskut paraqesin synimet që të njohin dhe menaxhojnë potencialin dhe shqetesimet e paparashikuara që mund të ndodhin kur projekti është duke u zbatuar.



Menaxhimi i Riskut

Menaxhimi i riskut të projektit përfshinë dhënjën e përgjigjes mbi pyetjet e tilla si :

- ▶ Çfarë është e mundëshme që të ndodhë (probabiliteti dhe ndikimi)?
- ▶ Çfarë mundë të bëhet për të minimizuar probabilitetin apo ndikimin e këtyre ngjarjeve?
- ▶ Çfarë sinjalesh do të sinjalizojnë nevojën për një veprim të tillë?
- ▶ Cilat janë rezultatet më të mundshme të këtyre problemeve dhe reagimeve që parashikohen?




Menaxhimi i Riskut

- Risku i projektit bazohet në një ekuacion të thjeshtë:

Risku = Probabiliteti i ngjarjes x Pasojat e ngjarjes

Risku dhe oportuniteti (mundësitë) përbëjnë anët e kundërta të së njëjtës medalje-mundësia krijohet nga rrethanat e favorshme të projektit dhe risku nga ngjarjet e pafavorshme.



Menaxhimi i Riskut – Proces me katër hapa

Menaxhimi i riskut është një qasje proaktive.

Është proces parandalues për të siguruar uljen e surprizave të pakëndshme dhe minimizimin e pasojave negative në lidhje me ngjarjet e padëshirueshme.

Burimet e rreziqeve të projektit të njohura si kërcënime nga mjedisi rrethues janë të pakufizuara, të tilla si:

- ▶ pranueshmëria nga tregu
- ▶ inflacioni
- ▶ kurset e këmbimit dhe
- ▶ legjislacioni / rregulloret e qeverisë.

Rreziqet e jashtme janë shumë të rëndësishme dhe duhen të adresohen



Menaxhimi i Riskut – Proces me katër hapa

- Komponentët kryesor të procesit të menaxhimit të riskut janë:

1. Identifikimi i riskut

- procesi i përcaktimit të faktorëve specifik të riskut që mund të parashikohen në masë të arsyeshme që ndikojnë në projekt.

2. Analiza e probabilitetit dhe pasojave

- ndikimi i mundshëm i këtyre faktorëve të riskut, i përcaktuar me mundësinë që ato të ndodhin dhe efektin që do të kenë në projekt nëse ndodhin.

Menaxhimi i Riskut – Proces me katër hapa

- Komponentët kryesor të procesit të menaxhimit të riskut janë:

3. Strategjitë e zbutjes së riskut

- hapat që ndërmerren për të minimizuar ndikimin e mundshëm të faktorëve të riskut që vlerësohen se kërcënojnë në mënyrë të mjaftueshme projektin.

4. Kontrolli dhe dokumentimi

- krijimi i bazës së nevojshme të informacionit për projektet e ardhshme duke u bazuar tek mësimet e nxjerra.


Identifikimi i riskut

Procesi i menaxhimit të riskut fillon me përpjekjen për gjenerimin e një liste me rreziqet potenciale.

MP krijon ekipin e menaxhimit të riskut të cilët me teknikën brainstorming gjenerojnë risqe të mundshme.

Klasifikimet e rrezikut:

- ▶ Risku financiar
- ▶ Risku teknik
- ▶ Risku komercial
- ▶ Risku i zbatimit
- ▶ Risku ligjor apo kontraktual



Identifikimi i riskut

Disa nga tipet më të zakonshme të riskut që mund të paraqiten në shumicën e projekteve

- ▶ Mungesat e vazhdueshme
- ▶ Dorëheqjet
- ▶ Staf shtesë/ aftësi jo e mirë
- ▶ Trajnim joefektiv
- ▶ Përcaktim i dobët i specifikimeve fillestare
- ▶ Ndryshimet e shumta të punës / porosive për arsye të problemeve të shumta.

Një teknikë efektive për identifikimin e rrezikut është SZP struktura e zberthimit të punës, zvogëlon mundësin që një ngjarje me risk të mos evidentohet.

Identifikimi i riskut

Një numër metodash përdoren për të identifikuar faktorin rrezik duke përfshirë:

- ▶ Takimet brainstorming
- ▶ Opinioni i ekspertëve
- ▶ Historia në të kaluarën
- ▶ Vlerësimet e bazuara në grupe



Faktoret e zhvillimit te grupit

- ▶ Krijimi I profilit të riskut është një element I rëndësishëm.
- ▶ Eshtë një listë e pyetjeve që përcakton fushat tradicionale të pasigurisë së projektit.



Profili i Riskut për projektin e prodhimit të një produkti

Kërkesat teknike

Cilësia

A janë kërkesat e qëndrueshme?

A është cilësia e përfshirë në dizajn

Dizajni

Menaxhimi

A varet dizajni nga supozimet optimiste apo jo reale?

A i kanë të qarta njerëzit autoritetet dhe ndarjet e përgjegjësisive

Testimi

Ambienti punues

A janë pajisjet e testimit atëherë kur duhen?

A punojnë njerëzit në mënyrë bashkëpunuese gjatë realizimit të detyrave

Zhvillimi

Stafi

A është procesi i zhvillimit i mbështetur nga një set i krahasueshëm i metodave dhe mjeteve?

A është stafi kompetent ose a është i pamjaftueshëm?

Afati kohor

Klienti

A është koha e varur nga përfundimi i projekteve të tjera?

A e din klienti se çfarë rezultatesh përfundimtare do të ketë (përfitimet) me realizimin e projektit?

Buxheti

Kontraktorët

Sa të besueshme janë vlerësimet e shpenzimeve?

A ka paqartësi në detyrat e përcaktuara për kontraktorët

Hapi 2 – Vleresimi i Riskut

Pas procesit të analizës së faktorëve të riskut, një numër i madhe situatash apo burimesh mund të jenë të pambuluara dhe si rrjedhojë një vlerësim i ndikimit të riskut të mundshëm duhet të ndërmerret.



Hapi 2 – Vleresimi i Riskut

vazhdim

- ▶ Në këtë hap menaxherët zhvillojnë metoda të eliminimit të rreziqeve të parëndësishme dhe ndajnë ato të denja nga niveli i rëndësisë që kanë nevojë për vëmendje.

Anëtarët e ekipit të riskut vlerësojnë rëndësinë e çdo risku përmes këtyre dy kiterëve:

- ▶ Probabiliteti i ngjarjes dhe
- ▶ Ndikimi i ngjarjes



Forma e vlerësimit të riskut

Ngjarja e riskut	Probabiliteti	Ndikimi	Vështirësia e zbulimit	Kur
Problemet e brendshme	4	4	4	Shndërrimi
Ngrirja e sistemit	2	5	5	Fillimi
Reagimi I përdoruesit	4	3	3	Pasinstalimi
Keq funksionimi I Hardware	1	5	5	Instalimi

Një shembull I pjesshëm I një forme vlerësimi të riskut I përdorur në një projekt përditësimi të Windows 7 në verzionin 8

Ndikimi

Probabiliteti

5					
4			Reagimi perdor.	Prob. e brend.	
3					
2					Ngritja e sistemit
1					Keqfunk.
	1	2	3	4	5

Matrica e Riskut

Risk i ulet
Zona e gjelbert

Risk i moderuar
Zona portokalle

Risk i madh
Zona e kuqe

Matrica e riskut përbëhet nga një grup 5 x 5 elemente që cdo element përfaqëson një grup të ndryshëm të ndikimit dhe të vlerave.

Analiza e probabilitetit

- ▶ Ka mjaft teknika që ndihmojnë në vlerësimin e riskut.
- ▶ Variacionet statistikore të vlerës aktuale neto (NPV) përdoren për të vlerësuar risqet e rrjedhës së parasë në projekte.
- ▶ PERT (teknika e vlerësimit dhe rishikimit të programit) dhe stimulimi i PERT mund të përdoren për të shqyrtuar veprimtarinë dhe riskun e projektit.
- ▶ PERT jep më shumë një perspektivë makro duke e parë më shumë në koston e përgjithshme dhe risqet e lidhura me kohën.

Hapi 3 – Strategjite e zbutjes se Riskut

- ▶ Kur identifikohen rreziqet duhet të merren vendime për të menjanuar ato.

Përgjigjet ndaj riskut mund të klasifikohen si:

- ▶ Zbutje e riskut
- ▶ Shmangje e tij
- ▶ Transferim i riskut dhe
- ▶ Pranim i riskut



Planifikimi i emergjencave

Matrica e pergjigjeve ndaj riskut

Ngjarja e riskut	Përgjigjja ndaj riskut	Plani I emergjences (PE)	Rezultati i (PE)	Kur
Problemet me lidhjet e brendshme	Zbutja: Testimi I prototipit	Të përpiqesh deri sa të vijë ndihma	E pazgjidhur për 24h	Blerta
Ngrirja e sistemit	Zbutja: Testimi I prototipit	Riinstalimi i OS	Akoma e ngrirë pas 1 h	Artani
Reagimi I përdoruesit	Zbutja: Demonstrimi I projektit	Rritja e stafit mbështetës	Telefonatë nga top menaxhmenti	Albani
Keq funksionimi I Hardware	Lehtesues: Zgjedhja shitesit Transferues: Garancia	Zëvendësim porosie	Pajisjet dështojnë	Alba

Hapi 4 – Kontrolli dhe dokumentimi i përgjigjes ndaj riskut

- ▶ Rezultatet e mbledhura nga tre hapat e para në procesin e menaxhimit të riskut përmbledhen në një dokument zyrtar që quhet regjistri i riskut.
- ▶ Një regjistër përmban të gjitha risket e identifikuara ku përfshihet përshkrimi, kategoritë, probabiliteti i ndodhjes, ndikimi, përgjigjet, planet e emergjencës. Pronarët dhe gjendja aktuale.
- ▶ Dokumentimi i analizës së riskut paraqet komponentin kryesor final në të gjithë procesin e menaxhimit të riskut.



Menaxhimi i riskut të projektit – një metodë e integruar

- ▶ Shoqata Europiane e Menaxhimit të Projekteve ka ndërtuar një program të integruar të menaxhimit të riskut, për të shtrirë menaxhimin e riskut që të përfshijë gjithë ciklin e jetës së projektit.
- ▶ Ky program i njohur si Analiza dhe Menaxhimi i Riskut të Projektit (PRAM) paraqet metodologjinë që aplikohet në një mjedis me shumë projekte që përfshinë komponentët kryesore të menaxhimit të riskut.

Menaxhimi i riskut të projektit – një metodë e integruar

Modeli PRAM

Fazat e vlerësimit të riskut të projektit përfshijnë 9 hapat siç vijon:

1. Definimin – Sigurimi që projekti është përcaktuar qartë, duke përfshirë gjitha rezultatet dhe qëllimet që kërkohen të arrihen.
2. Fokusimi – fillon me planifikimin e procesit të menaxhimit të riskut (MR) të projektit dhe përcaktimin e metodave më të mira në adresim të riskut
3. Identifikimi – vlerësimin e burimeve specifike të riskut dhe përgjigjet ndaj tyre.
4. Strukturimi – Shqyrtimi dhe rishikimi i mënyrës se si janë klasifikuar risqet për projektin dhe krijimi i skemës së prioritizimit të risqeve.

Menaxhimi i riskut të projektit – një metodë e integruar

Modeli PRAM

5. Përkatësia – qartësimi i pronësisë së risqeve që ndërmarrja dhe klientët në anën tjetër kanë vullnetin t'i përballojnë si dhe alokimin e përgjegjësive për (MR).
6. Parashikimi - Vleftësimi – i ndikimeve në projekt për risqet e identifikuara si dhe zgjidhjet e propozuara.
7. Vlerësimi – vlerësimi kritik i rezultateve të fazës së mëparshme për të përcaktuar planin më të mundshëm të realizimit të risqeve.
8. Planifikimi – përgatitja e planit të MR të projektit që ofron në mënyrë proaktive strategjitë e minimizimit të riskut për projektin siç nevojitet.
9. Menaxhimi – monitorimi i progresit aktual me planet e projektit dhe ato të MR që e shoqëron.


Struktura e PRAM

Modeli PRAM

Krijon një strukturë të unifikuar që mundëson menaxhimin efektiv të riskut.

Nga skema vihen re dy dy linja feedbacku (lidhje prapavajtëse)

PRAM siguron një formë të ngjashme që e lejon menaxhimin e lartë që të bëjë krahasime të kujdesshme ndërmjet të gjithë projekteve të përfshirë në portfolin e ndërmarrjes.





Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu

butrint.batalli@universitetiaab.com